



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.831/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë,në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “Burimi - E” SH.P.K., me seli në Ferizaj, fshati Babush, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.Q. dhe L.Q.I., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurit Kuvendi Komunal Fushë Kosovë, me seli në Fushë Kosovë, me objekt kontesti anulim i Vendimit nr.562 të datës 22.05.2023 dhe nr.563 të datës 22.05.2023, duke vendosur për konfliktin e kompetencës ndërmjet Departamentit për Çështje Ekonomike dhe Departamentit të Cështje Administrative të Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Cështje Administrative të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në procedurë të mëtejme.

A r s y e t i m

Paditësi “Burimi - E” SH.P.K., me seli në Ferizaj, më datë 26.05.2023, përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, ka paraqitur padi së bashku me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit, të shtyhet ekzekutimi i vendimeve nr.562 të datës

22.05.2023 dhe vendimit nr.563 të datës 22.05.2023, deri sa gjykata të vendos me vendim përfundimtar.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin KA.nr.224/23, të datës 15.06.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe lëndën e ka dërguar për vendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Departamentit për Çështje Ekonomike, me arsyetim së në kuptim të dispozitave nga neni 13 të Ligjit 06/L-015 të Gjykatës Komerciale, kompetente është Gjykata Komerciale – Departamentit për Çështje Ekonomike, sipas kompetencës lëndore sepse Gjykata Komerciale – Departamentit për Çështje Ekonomike është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare, ndërmjet personave juridik publik dhe privat në çështjet e ndërsjella tregtare.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KE.nr.549/23 të datës 15.02.2024, ka iniciuar konfliktin e kompetencës duke konsideruar se kompetente është Gjykata Komerciale e Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, për faktin se çështjet që kanë të bëjnë për kontestet e iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative, nuk bien në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative.

Dhoma e Shkallës së Dytë, gjeti se me nenin 13 par 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar kompetenca lëndore e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë dhe Dhoma e Shkallës së Dytë si vijon: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative është kompetente në pikëpamje lëndore, për shkak se nga referati i padisë rezulton se çështjet që kanë të bëjnë për kontestet e iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative, nuk bien në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, por për të cilat kompetente për të

vendosur është Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, si i vetmi departament në gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur në këto çështje juridike.

Nga të cekurat konform Nenit 25.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos sikurse në dispozitiv.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.831/24, data 16.04.2024

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja

Saranda Bogaj Sheremeti